



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PA1.nr.1025/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm - në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Kadrije Goga - Lubishtani, kryetare e kolegjit, Ferit Osmani dhe Zyhdi Haziri - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale kundër të akuzuarit SH.A. , nga V, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i besimit, nga neni 330 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti, P.nr.469/21, më datë 13.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.09.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, **NDRYSHOHET**, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.469/21, datë 13.04.2022, ashtu që Gjykata e Apelit të Kosovës të akuzuarit SH.A. , për veprën penale Keqpërdorim i besimit, nga neni 330 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës) e për të cilën është shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë, dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh e merr si të vërtetuar dhe po ashtu i shqipton edhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) € e më pëlqimin e të akuzuarit konform të dispozitës së nenit 44 par.1 të KPRK-së i zëvendëson dënimin me burgim në dënim me gjobë, ashtu që i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) € e konform të dispozitës së nenit 76 par.1, 2 nënpar.2.4, të KPRK-së i shqipton dënim unik me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) € e të cilën gjobë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë atëherë i njëjti do të i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që për 20 (njëzet) € të gjobës i llogaritet 1 (një) ditë burg. I akuzuari obligohet që palës së dëmtuar të i kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 711.23 (shtatëqind e njëmbëdhjetë euro e njëzet e tre cent) € dhe këtë ta bëjë në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Në pjesët tjera aktgjykimi i ankimuar ngel i pa ndryshuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.469/21 datë 13.04.2022, të akuzuarin SH.A. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Keqpërdorim i besimit, nga neni 330 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), ashtu që të akuzuarit gjykata i përcakton dënimin me burg efektiv në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh. Konform nenit 44 par.1 të KPRK-ës dhe me pëlqimin e të akuzuarit, ia shndërron në dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) € dhe me dënim me gjobë prej 200 (dyqind) €. Dënimet e shqiptuara do t'i paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast të mos pagesës të njëjtit do t'i shndërrohet në dënim me burg efektiv prej 40 (katër dhjetë) ditësh, duke i llogaritur nga 20 (njëzet) € për 1 (një) ditë burgu. I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 10 (dhjetë) € kurse në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 10 (dhjetë) €. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore - juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko - civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim apo rivendosje, apo të njëjtin ta ndryshojë sa i përket vendimit mbi dënimin me burg dhe gjobë, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptojë dënim me burgim me të lartë.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën PPA/II.nr.1063/2022, datë 20.07.2022, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit të shqiptohet një dënim më i lartë me gjobë ose me burg efektiv.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se:

Ankesa është e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan është e bazuar.

Prokuroria Themelore në Gjilan e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke pretenduar se aktgjykimi është përpiluar në kundërshtim me nenin 370 par.7 të KPRK-ës, sepse gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të aktgjykimit nuk ka përfshirë pjesën e propozimit sipas aktakuzës së prokurorisë pasi që nuk e ka obliguar të akuzuarin në kompensimin e palës së dëmtuar "xxxx", L.L.C me seli në G. dhe atë në vlerë prej 711.23 €.

Pretendimet e lartë cekura të Prokurorit sipas vlerësimit të Kolegjit penal të kësaj gjykate, janë të bazuara dhe me evitimin e shkeljeve të lartë cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është

evituar edhe shkelja e ligjit penal në favor të të akuzuarit, ngase në rastin konkret në aktakuzën e prokurorisë kemi propozimin për obligimin e të akuzuarit për kompensimin e dëmit të të dëmtuarës “xxx” LLC, me seli në G. e me vet pranimin e fajësisë së të akuzuarit për veprën penale sipas aktakuzës ai e ka pranuar edhe dëmin që ai i ka shkaktuar të dëmtuarit dhe me pranimin e fajësisë. Me ndryshimin e aktgjykimi të gjykatës së shkallës së parë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi tani kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se aktgjykimi është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.7 të KPP-së e edhe është evituar shkelja e ligjit penal në favor të të akuzuarit.

Gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjyqimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve. Për këtë arsye, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit mbi dënimin.

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit mbi dënimin duke pretenduar se , të akuzuarit nuk i është shqiptuar dënim adekuat në pajtim me veprimet e tija, mënyrën e kryerjes, shkallën e përgjegjësisë, pasojnë e shkaktuar etj, pasi tek i akuzuari në fjalë përveç pranimit të fajësisë nuk ka ekzistuar asnjë rrethanë tjetër lehtësuese e cila si e tillë nuk është dashtë që të vlerësohet deri në këtë masë sa të zbutet dënimi në këtë mënyrë. Sipas vlerësimit të prokurorisë, gjykata nuk i ka marr parasysh rrethanat rënduese, sepse vetëm sikur të kishte pasur parasysh motivin që i ka paraprirë veprës penale e që është përfitimi i kundërligjshëm pasuror për vete dhe dëmtimi i interesave të personit tjetër dhe se me një dënim të tillë kaq të butë nuk do të arrihet qëllimi i dënimit. I propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës, ta anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim apo rivendosje, apo të njëjtin ta ndryshojë sa i përket vendimit mbi dënimin me burg dhe gjobë, ashtu që të akuzuarit t’i shqiptojë dënim me burgim me të lartë.

Gjykata e Apelit në Prishtinë vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorit që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i lartë janë të bazuara e sipas detyrës zyrtare e ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket kompensim të dëmit palës së dëmtuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar rrethanat lehtësuese, porse të njëjtat i ka mbivlerësuar, ndërsa rrethanat rënduese drejtë i ka konstatuar porse të njëjtat i ka nënvlerësuar e duke i marr parasysh edhe rrethanat e konstatuara në ankesën e Prokurorit tani Kolegji Penal i kësaj gjykate vlerëson se përgjegjësia penale e të të akuzuarit është më e lartë se sa siç e ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë e me obligimin e të akuzuarit për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar është evituar edhe shkelja e ligjit penal në favor të të akuzuarit e me ndryshimin e aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë, duke i shqiptuar dënim më të lartë me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dënimi i shqiptuar tani të akuzuarit është adekuat me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 71 par. 3. pika 1. 3 të KPRK-ës. Kështu gjykata si rrethana lehtësuese për të akuzuarin vlerësoi pranimin e fajësisë pa asnjë hezitim në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin për kryerjen e veprës penale, premtimin e tij se nuk do të përsëritë

vepra të tjera penale si dhe shprehjen e keqardhjes për rastin që ka ndodhur si dhe faktin se për gjykatës nuk është i njohur si kryerës i veprave penale pra është hera e parë që ndeshet me ligjin. Ndërsa si rrethana rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore dhe dëmin e shkaktuar me këtë vepër penale. Andaj duke u bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një konstatim të këtillë të rrethanave lehtësuese si të drejtë dhe të ligjshme i aprovon edhe Kolegji penal i kësaj gjykate, mirëpo të njëjtat nuk i ka vlerësuar në mënyrë meritore, të njëjtat i ka mbivlerësuar, ndërsa rrethanat rënduese vetëm i ka konstatuar, porse të njëjtat po ashtu nuk i ka vlerësuar në mënyrë meritore, andaj Kolegji Penal i kësaj gjykate, nga të lartë cekurat tani vlerëson se përgjegjësia penale e të akuzuarit është më e lartë se sa siç e ka vlerësuar dhe të akuzuarit tani i shqiptoj dënim më të ashpër si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e po ashtu të akuzuarin e obligoj që të dëmtuarit të ia kompensoj dëmin e shkaktuar dhe në këtë mënyrë i evitoj edhe shkeljet e ligjit penal në favor të të akuzuarit. Të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga Kolegji Penal i kësaj gjykate si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti i Përgjithshëm

PA1.nr.1025/22, më datë 27.09.2022

Zyrtarja ligjore,
Rrezarta Bala

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Kryetare e kolegjit,
Kadrije Goga - Lubishtani

Zyhdi Haziri